



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Në bazë të kreut III. Neni 19 lidhur me nenin 21 të Statutit të OAK-së (ndryshimet e plotësimet 07.07.2007), palët kontraktuese:

1. AVOKATI: \_\_\_\_\_, me zyre në \_\_\_\_\_ rr. \_\_\_\_\_ në cilësinë e avokatit (në tekstin e mëtejme: AVOKATI)

Dhe

2. \_\_\_\_\_, jurist i diplomuar me vendbanim në \_\_\_\_\_

Rr. \_\_\_\_\_ Nr. \_\_\_\_\_ në cilësinë e praktikantit (në tekstin e mëtejme: PRAKTIKANTI I AVOKATISË), lidhin këtë,

## K O N T R A T Ë

### MBI ANGAZHIMIN E PRAKTIKANTIT NË ZYRËN E AVOKATISË

1. Sipas kësaj kontrate, juristi angazhohet në zyrën e avokatisë, e cila gjendet në \_\_\_\_\_ Rr. \_\_\_\_\_, me qëllim të aftësisë, përgatitjes dhe pajisjes me njohuri praktike për ushtrimin e pavarur të profesionit,

Juristi i angazhuar sipas kësaj kontrate e ka statusin e praktikantit të avokatisë, të cilën e fiton me regjistrim në regjistrin e praktikantëve të avokatisë të cilën e udhëheq OAK.

2. Praktikanti i avokatisë u nënshtrohet dispozitave detyimore dhe disiplinore të aplikueshme për avokatët, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin mbi avokatinë, Statutin e OAK-së si dhe Kodin e Etikës Profesionale.

3. Praktikanti i avokatisë ka të drejtë që të zëvendësoj avokatinë në rastet dhe brenda kufijve të përcaktuara me ligj.

Praktikantit të avokatisë i ndalohet kryerja e punëve juridike në mënyrë të pavarur dhe për llogarinë e vet, por vetëm në kuadër të veprimtarisë së caktuar nga avokati. Gjatë kësaj, ai është i detyruar t'i përmbahet udhëzimeve të avokatit.

**3.** Ushtrimin e praktikës në zyrën e avokatisë, praktikanti i avokatisë do ta bëjë me orar të plotë ditor të punës sipas organizimit të orarit të punës në Zyre.

Praktikanti i avokatisë është i detyruar që të punoj në Zyrën e Avokatit në të cilën është caktuar në bazë të kësaj kontrate, sipas udhëzimeve të tij dhe duke respektuar organizimin e punës në zyre.

**4.** Praktikanti i avokatisë është i detyruar që gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, të marrë pjesë në të gjitha format e aftësimit profesional të caktuar nga OAK dhe vetë avokati.

**5.** Praktikanti i ka edhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë nga marrëdhënia e punës, sipas ligjit të punës.

**6.** Praktikantit të avokatisë i takon paga në shumën mujore prej \_\_\_\_\_Euro, deri në përfundimin e stazhit të përcaktuar me këtë kontratë, dhe e njëjta paguhet nga \_\_\_\_\_.

Avokati dhe praktikanti i avokatisë do të veprojnë në përputhje me ligjin, që ka të bëjë me taksat dhe tatimet në paga si dhe me sigurimet e detyrueshme pensional, invalidor dhe shëndetësor. Asnjëra nga palët nuk do të bartin përgjegjësi për mospërbushjen e detyrimeve ligjore të kësaj natyre nga ana e palës tjetër.

#### ***PËR ANGAZHIMIN VULLNETAR:***

Praktikanti i avokatisë angazhohet në Zyrën e Avokatit në bazë të sistemit vullnetar/pa pagesë. Sipas kësaj baze, avokati nuk ka detyrime ligjore që lidhen me taksat dhe tatimet në paga si dhe me sigurimet e detyrueshme për praktikantin e avokatisë.

**7.** Për dëmet e shkaktuara nga praktikanti, në kuadër të detyrës së praktikantit të avokatisë, është përgjegjës avokati mbikëqyrës. Nëse dëmi është shkaktuar, me qëllim ose nga pakujdesia e rëndë nga praktikanti i avokatisë, përgjegjës është praktikanti.

Avokati nuk do të ngarkohet me përgjegjësi në rast të lëndimit , të fatkeqësisë, sëmundjes apo humbjes së pasurisë që mund ta godasë praktikantin gjatë kohës së angazhimit të tij.

**8.** Koha e angazhuar sipas kësaj kontrate i llogaritet në stazh të praktikës, sipas ligjit përkatës, i cili llogaritet prej ditës së regjistrimit në librin e praktikantëve të avokatisë së OAK.

**9.** Për të gjitha çështjet e tjera që lidhen me pozitën dhe statusin e praktikantit të avokatisë si dhe ato që kanë të bëjnë me raportet reciproke midis tij dhe avokatit vlejné dispozitat e përcaktuara me dispozitat e OAK.

**10.** Kontrata është përpiluar në 5 (pesë) ekzemplarë të njëjtë, secili prej tyre i nënshkruar në mënyrë të rregullt nga të dy palët kontraktuese dhe në aplikim kanë efekt të barabartë juridik.

Kontrata është nënshkruar në \_\_\_\_\_, ditën e lidhjes.

**AVOKATI**

Emri/mbiemri

\_\_\_\_\_

Lib. Avok.nr. \_\_\_\_\_ dt. \_\_\_\_\_

Nr.personal: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**PRAKTIKANTI I AVOKATISË**

Emri/mbiemri

\_\_\_\_\_

Lindur: \_\_\_\_\_

Nr. personal: \_\_\_\_\_

**Shënim:** Kjo kontratë model është aprovuar nga Bordi Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës me datë 24.11.2008 !